



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 176

6 nëntor

2013

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i ERE nr. 119, datë 28.10.2013	Mbi miratimin e planprotokollit të pagesave ndaj palëve të treta të “CEZ Shpërndarje” sh.a. në administrim të përkohshëm për muajin nëntor 2013.....	7609
Vendim i ERE nr. 120, datë 28.10.2013	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “EN. ERGY” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	7609
Vendim i ERE nr. 121, datë 28.10.2013	Mbi fillimin e procedurave për modifikimin e licencës me nr. 17, seria PV04P, të shoqërisë “Marjakaj” sh.p.k. “Për prodhimin e energjisë elektrike” nga hec “Bene”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 43, datë 14.10.2004.....	7610
Vendim i ERE nr. 122, datë 28.10.2013	Për licencimin e shoqërisë “Zall Herr Energji 2011” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hecet “Cekreze 1” dhe “Cekreze 2”.....	7611
Vendim i ERE nr. 123, datë 28.10.2013	Për kualifikimin e impiantit prodhues të shoqërisë “Zall Herr Energji 2011” sh.p.k., si burim i rinovueshëm energjie nga hecet “Cekreze 1” dhe “Cekreze 2”.....	7612
Vendim i ERE nr. 124, datë 28.10.2013	Për licencimin e shoqërisë “Hidrocentrali Qarr & Kaltanj” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hecet “Qarr” dhe “Kaltanj”.....	7613
Vendim i ERE nr. 125, datë 28.10.2013	Për kualifikimin e impiantit prodhues të shoqërisë “Hidrocentrali Qarr & Kaltanj” sh.p.k. si burim i rinovueshëm energjie nga hecet “Qarr” dhe “Kaltanj”.....	7614
Vendim i ERE nr. 126, datë 28.10.2013	Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërive “Hec Ulëz-Shkopet” sh.a. dhe “Hec Bistrice 1, Bistrice 2” sh.a., për transferimin e licencave të prodhimit, tregtimit dhe furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike nga këto shoqëri te shoqëria “Kurum International” sh.a.....	7615

VENDIM
Nr. 119, datë 28.10.2013

**MBI MIRATIMIN E PLANPROTOKOLLIT TË PAGESAVE NDAJ PALËVE TË TRETA TË
“CEZ SHPËRNDARJE” SHA NË ADMINISTRIM TË PËRKOHSHËM PËR MUAJIN
NËNTOR 2013**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 14 pika 3 të rregullores “Për procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 1, datë 10.1.2013, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.10.2013, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë së Çmimeve dhe Tarifave, lidhur me skedulimin e pagesave dhe të planshpenzimeve të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a. (në administrim të përkohshëm),

konstatoi se:

Në kushtet e humbjeve prej 44.5% dhe arkëtimeve 78.3%, situata e kompanisë është shumë e vështirë dhe nuk jemi në kushtet e miratimit të një planprotokolli pagesash zë për zë, përveçse renditje të zërave prioritarë pa cenuar sigurinë e furnizimit me energji elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e renditjes së planprotokollit të pagesave ndaj palëve të treta të “CEZ Shpërndarje” sh.a. në administrim të përkohshëm për muajin nëntor 2013, si më poshtë:

a) Detyrimin mujor për prokurimin e energjisë elektrike për mbulimin e plotë të humbjeve në sistemin e shpërndarjes;

b) Detyrimin mujor të KESH sh.a.;

c) Detyrimin mujor të OST sh.a. deri në faturën korente;

d) Pagesa “të tjera”.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë “CEZ Shpërndarje” sh.a. (në administrim të përkohshëm), për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 120, datë 28.10.2013

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“EN. ERGY” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”, 9 dhe 13 pika 1 germa “d” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “g”, 8 dhe 10 pika 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë



9.9.2008, nenit 18 pika 1 germa “a” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.10.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “EN. ERGY” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “EN. ERGY” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10 germat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “EN. ERGY” sh.p.k. për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 121, datë 28.10.2013

MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS ME NR. 17, SERIA PV04P, TË SHOQËRISË “MARJAKAJ” SHPK, “PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE” NGA HEC “BENE”, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 43, DATË 14.10.2004

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”, 9, 13 pika 1 germa “a”, 19 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “a”, 10 pika 3, 15 pika 1, pika 2 germa “b”, pika 4 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, pikave 2.3 dhe 2.4 të “Licencës së prodhimit të energjisë elektrike”, nenit 18 pika 1 germa “a” të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.10.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Marjakaj” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së

Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Marjakaj” sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Neni 15, pika 4, germa “a”: Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës.

Meqenëse në kërkesën e subjektit aplikues për modifikim, saktësimi i parametrave teknikë të skemës së shfrytëzimit energjetik të ujërave të përroit të Benes nuk është dhënë i qartë, do të kërkohet nga ky subjekt, që brenda afatit dymujor të zbatimit të procedurave të ERE-s, të paraqitet në ERE një informacion teknik lidhur me saktësimin e këtyre parametrave.

- Neni 15, pika 4, germa “b”: Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit, të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për modifikimin e licencës me nr. 17, seria PV04P, të shoqërisë “Marjakaj” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec “Bene”, me fuqi 125 KW, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 43, datë 14.10.2004.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 122, datë 28.10.2013

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ZALL HERR ENERGJI 2011” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HECET “CEKREZE 1” DHE “CEKREZE 2”

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe nenit 13 pika 1 germa “a” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “a”, dhe neneve 13 dhe 14 pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.10.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Zall Herr Energji 2011” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Zall Herr Energji 2011” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:



- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Zall Herr Energji 2011” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hecet “Cekreze 1” me fuqi të instaluar 0,43 Mw dhe “Cekreze 2 me fuqi të instaluar 0,23 Mw.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 123, datë 28.10.2013

PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES TË SHOQËRISË “ZALL HERR ENERGJI 2011” SHPK, SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE NGA HECET “CEKREZE 1” DHE “CEKREZE 2”

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “ll”, 9 dhe 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe neneve 7 e 8 të “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 28.10.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Zall Herr Energji 2011” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues për hecet “Cekreze 1” dhe “Cekreze 2” si burim i rinovueshëm energjie,

konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “Zall Herr Energji 2011” sh.p.k., është konform “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, germat “a”, “b”, “c”, “d”

Përshkrimi i përgjithshëm i centralit.

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

- Neni 7, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “d”

Dokumentacioni vijues grafik, korografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

- Neni 7 pika 3, germat “a”, “b”, “c”

Përshkrimi i centralit.

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të kualifikojë impiantin prodhues të shoqërisë “Zall Herr Energji 2011” sh.p.k., si burim i rinovueshëm energjie nga hecet “Cekreze 1” dhe “Cekreze 2”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s

Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 124, datë 28.10.2013

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “HIDROCENTRALI QARR & KALTANJ” SHPK NË
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HECET “QARR” DHE
“KALTANJ”**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe nenit 13 pika 1 germa “a” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “a”, 5, pika 1 germa “a” dhe neneve 13 dhe 14 pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.10.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Hidrocentrali Qarr & Kaltanj” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Hidrocentrali Qarr & Kaltanj” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s



VENDOSI:

1. Të licençoitë shoqërinë “Hidrocentrali Qarr & Kaltanj” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hecet “Qarr” me fuqi të instaluar 1 Mw dhe “Kaltanj” me fuqi të instaluar 0,5 Mw.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 125, datë 28.10.2013

PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES TË SHOQËRISË “HIDROCENTRALI QARR & KALTANJ” SHPK SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE NGA HECET “QARR” DHE “KALTANJ”

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “ll”, 9 dhe 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe neneve 7 e 8 të “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 28.10.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Hidrocentrali Qarr & Kaltanj” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues për hecet “Qarr” dhe “Kaltanj”, si burim i rinovueshëm energjie,

konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “Hidrocentrali Qarr & Kaltanj” sh.p.k. është konform “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”

Përshkrimi i përgjithshëm i centralit.

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

- Neni 7, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”

Dokumentacioni vijues grafik, korografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

- Neni 7 pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”

Përshkrimi i centralit.

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të kualifikojë impiantin prodhues të shoqërisë “Hidrocentrali Qarr & Kaltanj” sh.p.k., si burim i rinovueshëm energjie nga hecet “Qarr” dhe Kaltanj”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 126, datë 28.10.2013

**MBI SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRIVE “HEC ULËZ-SHKOPET” SHA DHE
“HEC BISTRICA 1, BISTRICA 2” SHA, PËR TRANSFERIMIN E LICENCEVE TË
PRODHIMIT, TREGTIMIT DHE FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA KËTO SHOQËRI TE SHOQËRIA “KURUM INTERNATIONAL” SHA**

Në mbështetje të nenit 9 dhe 20 pika 1 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 17 pikat 1, 4 germet “a”, “b”, “c”, 5 dhe 7 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, pikës 1.3 të licencës së aktivitetit të tregtimit dhe të furnizuesit të kualifikuar, Bordi i Komisionerëve i ERE-s në mbledhjen e datës 28.10.2013, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

1. ERE, në bazë të nenit 4 pika 3 të “Rregullores së transferimit të asetëve”, në të cilin citohet se: “Për transferimin e asetëve që realizohet në kuadër të procesit të privatizimeve në sektorin publik, nuk do të aplikohet kjo rregullore”, në kompetencë të saj ka vetëm trajtimin e transferimit të licencave të subjekteve “Hec Ulëz-Shkopet” sh.a. dhe “Hec Bistrica 1, Bistrica 2” sh.a.

2. Dokumentacioni i paraqitur nga subjektet “Hec Ulëz-Shkopet” sh.a. dhe “Hec Bistrica 1, Bistrica 2” sh.a., në lidhje me transferimin e licencave, është konform kërkesave të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Neni 17, pika 1, pika 4, germet “a”, “b”, “c”

Është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë transferimin e licencave të prodhimit, tregtimit dhe furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike nga shoqëritë “Hec Ulëz-Shkopet” sh.a. dhe “Hec Bistrica 1, Bistrica 2” sh.a., te shoqëria “Kurum International” sh.a.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e shoqërisë “Kurum International” sh.a. për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit Ahmeti

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 10 lekë